

Llogaritja e shkallës së kontributit të fondeve pensionale¹

Kontributi i fondit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional llogaritet në mënyrën e njëjtë në shumën nominale dhe në shumën reale. Kjo llogaritje bëhet në fund të qershorit dhe dhjetorit çdo vjet për periudhën 7-vjeçare, respektivisht 84 muaj dhe në atë rast periudha e llogaritjes është 84 muaj.

Nëse fondi ekziston më shkurt se 84 muaj, por më gjatë se 12 muaj, kontributi llogaritet në fund të qershorit, respektivisht dhjetorit, për periudhën nga 1 qershor, respektivisht dhjetor pas themelimit të fondit deri në fund të qershorit, respektivisht dhjetorit kur bëhet llogaritja. Në atë rast periudha e llogaritjes është 78, 72, 66, 60, 54, 48, 42, 36, 30, 24, 18 ose 12 muaj.

Dhe në të dy rastet kontributi reduktohet në nivel vjetor.

Kontributi në shumën nominale është ndryshimi (ritja) në përqindjet e vlerës së njësisë së kontabilitetit në datën e fundit të vlerësimit nga periudha e llogaritjes dhe vlerës së njësisë së kontabilitetit në ditën e fundit të muajit që i paraprinë muajit të parë në periudhën e llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën nominale. Kontributi në shumën nominale shprehet në përqindje me dy vende decimale dhe llogaritet me shfrytëzimin e formulës në vijim:

$$R_{nom} = \left(\frac{SE_t}{SE_0} \right)^{\frac{365}{t}} - 1,$$

ku,

R_{nom} është shkalla e kontributit në shumën nominale për periudhën e llogaritjes, SE_t është vlera e njësisë së kontabilitetit në ditën e fundit nga periudha e llogaritjes
 SE_0 është vlera e njësisë së kontabilitetit në ditën e fundit nga muaji i cili i paraprinë muajit të parë në periudhën e llogaritjes
 t është numri i ditëve në periudhën e llogaritjes.

¹ Deri në miratimin e ndryshimeve të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Ligjit për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital nga janari 2013, kontributi i fondit pensional ishte llogaritur për periudhën 3-vjeçare, i reduktuar në nivel vjetor, ndërsa tani llogaritet për periudhën 7-vjeçare, i reduktuar në nivel vjetor. Me këto ndryshime futet edhe publikimi i kontributit në shumën reale përveç kontributit në shumën nominale.

Kontributi në shumën reale për çdo periudhë të llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën reale, llogaritet në bazë të shkallës vjetore të kontributit në shumën nominale dhe ndryshimit të nivelit të shpenzimeve të jetës në periudhën e llogaritjes së reduktuar në nivel vjetor me shfrytëzimin e formulës në vijim:

$$R_{real} = \frac{1 + R_{nom}}{\left(\prod_k \left(1 + \frac{i_k - 100}{100} \right) \right)^{\frac{365}{t}}} - 1,$$

ku,

R_{real} është shkalla e kontributit në shumën reale për periudhën e llogaritjes,
 R_{nom} është shkalla e kontributit në shumën nominale për periudhën e llogaritjes,
 t është numri i ditëve në periudhën e llogaritjes,
 i_k është indeksi i shpenzimeve të jetës, i publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë, në fund të qershorit, respektivisht dhjetorit në çdo vjet lidhur me qershorin ose dhjetorin në vitin paraprak, duke filluar nga viti i llogaritjes me radhë për të gjitha vitet në periudhën e llogaritjes dhe gjysmëvjetorin e fundit në periudhën e llogaritjes në rastin që ai të jetë 78, 66, 54, 42, 30 ose 18 muaj.

Shembulli 1

Fondi pensional A ka filluar me punë më 01.01.2005 dhe ka punuar 8 vjet deri në ditën e llogaritjes 31.12.2012. Në atë rast periudha e llogaritjes është 84 muaj. Vlera e njësisë së kontabilitetit të fondit pensional më 31.12.2012 është 146 denarë, ndërsa më 31.12.2005 është 103 denarë.

i) E llogarisim shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën nominale të fondit pensional A për 84-periudhë mujore më 31.12.2012.

Pra:

$SE_0 = 103$; $SE_t = 146$ dhe $t = 2557$ (numri i ditëve nga 31.12.2005 deri më 31.12.2012)

$$R_{nom} = \left(\frac{SE_t}{SE_0} \right)^{\frac{365}{t}} - 1 = \left(\frac{146}{103} \right)^{\frac{365}{2557}} - 1 = 5,11\%$$

ii) E llogarisim shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën reale të fondit pensional A për 84-periudhë mujore më 31.12.2012.

Pra:
 $R_{nom} = 5,11\%$; $t = 2557$

<i>Indeksi i shpenzimeve</i>	
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2012 lidhur me dhjetorin 2011	$i_1 = 104,75$
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2011 lidhur me dhjetorin 2010	$i_2 = 102,79$
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2010 lidhur me dhjetorin 2009	$i_3 = 103,08$
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2009 lidhur me dhjetorin 2008	$i_4 = 98,35$
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2008 lidhur me dhjetorin 2007	$i_5 = 105,11$
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2007 lidhur me dhjetorin 2006	$i_6 = 105,59$
indeksi i shpenzimeve të jetës në dhjetor 2006 lidhur me dhjetorin 2005	$i_7 = 103,8$

$$R_{real} = \frac{1 + 5,11\%}{\left(\left(1 + \frac{104,75 - 100}{100}\right) \left(1 + \frac{102,79 - 100}{100}\right) \left(1 + \frac{103,08 - 100}{100}\right) \left(1 + \frac{98,35 - 100}{100}\right) \left(1 + \frac{105,11 - 100}{100}\right) \left(1 + \frac{105,59 - 100}{100}\right) \left(1 + \frac{103,08 - 100}{100}\right) \right)^{\frac{365}{2557}} - 1}$$

$$= \frac{1,0511}{1,0333} - 1 = 1,72\%$$

Shembulli 2

Fondi pensional A ka filluar me punë më 01.09.2006 dhe ka punuar 5 vjet e 10 muaj deri në ditën e llogaritjes (30.06.2012). Në atë rast periudha e llogaritjes është 66 muaj. Vlera e njësisë së kontabilitetit të fondit pensional më 30.06.2012 është 129 denarë, ndërsa më 31.12.2006 është 102 denarë.

i) E llogarisim shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën nominale të fondit pensional A për 66-periudhë mujore më 30.06.2012.

Pra:
 $SE_0 = 102$; $SE_t = 129$ dhe $t = 2008$ (numri i ditëve nga 31.12.2006 deri më 30.06.2012)

$$R_{nom} = \left(\frac{SE_t}{SE_0} \right)^{\frac{365}{t}} - 1 = \left(\frac{129}{102} \right)^{\frac{365}{2008}} - 1 = 4,36\%$$

ii) E llogarisim shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën reale të fondit pensional A për 66-periudhë mujore më 30.06.2012.

Pra:
 $R_{nom} = 4,36\%$; $t = 2008$

<i>Indeksi i shpenzimeve</i>	
indeksi i shpenzimeve të jetës në qershor 2012 lidhur me qershor 2011	$i_1 = 102,32$
indeksi i shpenzimeve të jetës në qershor 2011 lidhur me qershorin 2010	$i_2 = 104,24$
indeksi i shpenzimeve të jetës në qershor 2010 lidhur me qershorin 2009	$i_3 = 101,69$
indeksi i shpenzimeve të jetës në qershor 2009 lidhur me qershorin 2008	$i_4 = 98,44$
indeksi i shpenzimeve të jetës në qershor 2008 lidhur me qershorin 2007	$i_5 = 109,71$
indeksi i shpenzimeve të jetës në qershor 2007 lidhur me qershorin 2006	$i_6 = 101,25$

$$R_{real} = \frac{1 + 4,36\%}{\left(\left(1 + \frac{102,32 - 100}{100} \right) \left(1 + \frac{104,24 - 100}{100} \right) \left(1 + \frac{101,69 - 100}{100} \right) \left(1 + \frac{98,44 - 100}{100} \right) \left(1 + \frac{109,71 - 100}{100} \right) \left(1 + \frac{101,25 - 100}{100} \right) \right)^{\frac{365}{2008}} - 1}$$

$$= \frac{1,0436}{1,0315} - 1 = 1,17\%$$